



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS  
DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE

FEDERATA E PUNONJESVE TE  
TEKSTILIT, KONFEKSIONEVE  
LËKURËS DHE SHËRBIMEVE  
ARTIZANALE TË SHQIPËRISË

Nr. Prot 493 datë 20/03/2015

Nr. prot 28 datë 20/03/2015

**MARRËVESHJE**  
**MBI**

**BASHKËPUNIMIN E INSPEKTORATIT SHTETËROR TË PUNËS DHE**  
**SHËRBIMEVE SHOQËRORE**

**DHE**  
**FEDERATËS TË PUNONJËSVE TË TEKSTILIT, KONFEKSIONEVE, LËKURËS DHE**  
**SHËRBIMEVE ARTIZANALE TË SHQIPËRISË**

Mbështetur në:

- Nenin 15 dhe nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 i ndryshuar "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë".
- Ligjit Nr.9634, datë 30.10.2006, "Për inspektimin e Punës" dhe të përcaktimeve që parashikon ky ligj, si legjislacion i punës.
- Ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetit në punë".

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (që këtej e tutje "Inspektorati i Punës") duke i trajtuar organizimet sindikale, si partnerë të rëndësishëm në arritjen e qëllimeve të përbashkëta, për përmirësimin e kushteve të punës dhe luftën kundër informalitetit; dhe Federata e Punonjësve të Tekstilit, Konfeksioneve, Lëkurës dhe Shërbimeve Artizanale të Shqipërisë, e regjistruar si person juridik me vendimin Nr.7, datë 22.02.1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (që këtej e tutje "Sindikata e Fasonit"), së bashku përmendur si "Palët", bien dakord për sa më poshtë vijon:

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është sensibilizimi, informimi, këshillimi, i subjekteve që janë objekt inspektimi nga Inspektorati i Punës, veçanërisht në sektorin prodhim (fason), për të drejtën e tyre për tu organizuar kolektivisht në formën e sindikatave, për lidhjen e kontratave kolektive, në mbrojtje të punëmarrësve në ushtrimin e profesionit të tyre. Marrëveshja synon kontributin e përbashkët të palëve në shmangien e informalitetit, në mbrojtjen e kushteve të punës, të kohëzgjatjes së punës, pagave, sigurimit, higjenes dhe mirëqenies, kualifikimin profesional, trajtimin e shëndetit mjeksor, punësimit të fëmijëve, të grave, dhe të çështjeve të tjera që lidhen ngushtë me to. Palët bien dakord të shkëmbejnë informacion, të planifikojnë dhe bashkërendojnë veprimet e tyre për të realizuar këtë qëllim.

**Neni 2**  
**Objekti i veprimeve**

*Palët bien dakort se objekt i veprimeve të njëkohshme të tyre është:*

- a) Shkëmbimi i informacionit për shkelje të legjislacionit të punës, që cënon interesat social-ekonomike të punëmarrësve.
- b) Inspektorati i Punës mirëpret dhe angazhohet të trajtojë me prioritet dhe korrektësi, konform kuadrit ligjor, çdo ankesë të ardhur nga përfaqësitë sindikale.
- c) Sindikata e Fasonit angazhohet për të informuar Inspektoratin e Punës, për çdo të dhënë që ajo ka dijeni lidhur me punësimin informal.
- d) Sindikata e Fasonit merr përsipër të informojë Inspektoratin e Punës, për rastet e konstatimit të diskriminimit të punëmarrësve për shkak të marrjes pjesë në sindikatë, me qëllim marrjen e masave për të përmirësuar situatën e krijuar.
- e) Sindikata e Fasonit merr përsipër të vërë në dispozicion të Inspektoratit të Punës listën e subjekteve që janë anëtare të saj, së bashku me kontratat kolektive, duke e pasuruar vazhdimisht këtë listë me anëtarët që shtohen rishtaz.
- f) Inspektorati i Punës merr përsipër organizimin e fushatave sensibilizuese në drejtim të informimit për të drejtat dhe detyrimet ligjore që rrjedhin nga zbatimi i Legjislacionit të Punës.


**Neni 3**  
**Parimet**

Palët bien dakord që në zbatimin e e kësaj Marrëveshjeje do të udhëhiqen nga parimi i zbatimit me rigorozitet të legjislacionit në fuqi, trajtimit me respekt dhe objektivitet të subjekteve të inspektimit, duke pasur parasysh të drejtat dhe detyrimet e tyre në përputhje me ligjin.

**Neni 4**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin nga Palët.

INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNË  
DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE



FEDERATA E SINDIKATAVE  
TË PUNONJËSVE TË TEKSTILIT  
KONFEKSIONEVE, LËKURËS  
DHE SHËRBIMEVE ARTIZANALE  
TË SHQIPËRISË

KRYETARI

HAJDAR KANANI

